

BASHKIA KAVAJE**NJOFTIM PËR BOTIM****PËR****Dhënien me qira të pasurisë “Tokë e pafrytshme me sipërfaqe 2000 m²”, njësi në Pronësi të Njesisë Administrative Golem, Bashkia Kavajë**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit 139/ 2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKM-së Nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.6756, datë 03.09.2015 “Për zbatimin e VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, dhe Vendimit nr.26, datë 21.05.2016, të Këshillit Bashkiak Kavajë të konfirmuar nga Prefektura Tiranë me shkresën nr.2991/11 prot. datë 14.11.2016

NJOFTON:

Fillimin e procedurave për dhënien me qira, me konkurrim të pasurisë “Tokë e pafrytshme me sipërfaqe 2000 m²”, njësi në Pronësi të Njesisë Administrative Golem, Bashkia Kavajë

Dhënia me qira e pasurisë bëhet me qëllimin e ushtrimit të aktivitetit për parkim, duke mundësuar kryerjen e investimeve dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Vlera dysheme për detyrimin e qirasë, për fillimin e konkurrit është 54.000 (Pesëdhjetekatër mijë) lekë/vit.

Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie është 10 (dhjetë) vjet.

Vlerësimi i ofertave të konkurrentëve do të bëhet me pikët si vijon:

- | | | |
|--------------------------------------|----|------|
| - Niveli I investimit | 30 | pikë |
| - Niveli I punësimit | 20 | pikë |
| - Oferta e detyrimit mujor të qirasë | 50 | pikë |

Konkurrimi do të zhvillohet më datë 27.12. 2016 ora 10.00 në Bashkinë Kavajë, sipas procedurave të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Konkurrentët do të paraqesin para komisionit, deri në datën 27.12. 2016 ora 10.00

1. Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;
- b) Plan biznesin, i vulosur dhe i firmosur në çdo faqe, ku të përshkruhet qartë qëllimi i përdorimit, aktiviteti që do të zhvillohet, plani i investimeve, vlera e investimeve, zërat dhe fazat e zhvillimit të tyre, plani i punësimit, periudha e realizimit të tyre, kontraktorët e huaj (nëse ka) me të cilët janë lidhur kontrata biznesi ose kontrata paraprake biznesi, në gjuhën shqipe dhe të vendit të origjinës, të noterizuara etj.
- c) Ofertën për detyrimin vjetor të qirasë.
- ç) Ekstraktin e regjistrimit të subjektit të lëshuar nga QKB.
- d) Ekstraktin historik të regjistrimit të subjektit të lëshuar nga QKB
- dh) NIPT-in e subjektit, fotokopje e noterizuar
- e) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore

f) Vërtetim nga institucionet përkatëse se subjekti nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka proces gjyqësor që lidhet me veprimtarinë që ushtron.

g) Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira në objekte pronë shtetërore, të paraqesë vërtetim nga institucioni që administron pronën për shlyerje të detyrime

